

Investitorët e huaj: Pengesë ligji për minierat

GAZETA SOT : Tërhequr më 23 Qershor 2010

Përfaqësuesit e Shoqatës së Investitorëve të Huaj, kundërshtojnë disa pika të ligjit të ri për sektorin minerar. Sipas tyre, ky ligj i pengon edhe më shumë investimet e huaja.

Ekspertë të kësaj shoqate, të pranishëm në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, theksuan se problemi më i madh në ndryshimin e ligjit qëndron tek zvogëlimi i sipërfaqeve të shfrytëzimit si dhe zvogëlimi i afateve. Nga ana tjetër, Kryetari i Komisionit, Jemin Gjana deklaroi se vërejtjet e paraqitura nga ana e Shoqatës së Investitorëve të Huaj, nuk mund të çojnë në ndryshimin e mëtejshëm të ligjit. Ndryshimet në ligjin për Sektorin Minerar, janë diskutuar për disa javë me radhë në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese. Ky draft është shqyrtuar në disa seanca në komision për shkak të mangësive në hartimin e tij. Ndërkohë që ka kaluar në debate pa fund mes hartuesve grupeve të interesit dhe deputetëve. Propozimi i Ministrisë së Ekonomisë i cili është pasqyruar edhe në ligj parashikon ndarjen e lejeve për aktivitetin e kërkimit dhe atë të zbulimit duke e arsyetuar me faktin se kjo do të bëjë që një subjekt të mos e mbajë për shumë kohë të bllokuar një sipërfaqe tokësore pa shfrytëzuar. Nga ana tjetër, anëtarët e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese kanë kërkuar bashkimin e këtyre lejeve në një të vetme duke i lehtësuar sipas tyre punën investitorëve. Sipas deputetëve leje pranë METE-s duhet marrë vetëm në momentin që subjekti vendos të fillojë zbulimin për mineral. Por është kundërshtuar nga hartuesit e draftit të cilët nuk ka mbështetur një ndryshim të tillë në ligj duke vënë theksin tek fakti se në rastet kur jepet leja për kërkim ndaj një subjekti ajo i bëhet me kushtin që të dhënat që përfiton t'ia ofrojë shtetit ndërsa nëse liberalizohet ky proces këto materiale atëherë asnjë subjekt nuk do të jetë i detyruar që të dhënat e akumuluar t'ia japë ministrisë. Me gjithë kontestimet ligji ka kaluar në komision dhe pritet vetëm miratimi i tij me seancë plenare.